- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktajnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parrealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 PAGESA PAS SHKËPUTJES SË KONTRATËS

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 624-24-5754-5-2-1/C1168

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Pershkrimi i nenit	Neni. Nr.	Ndërtimi i QKMF-së në Gjinoc - RITENDER me numër identifikues: 624-24-5754-5-2-1 & 624-24-32-521
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 26,108.41 euro 10% e vlerës së kontratës për një periudhë prej 180 ditësh
Përgjegjësia dhe Sigurimi Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët

		brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë 150 ditë kalendarike
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim të ZKA-së.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve (shëno nr. e viteve të periudhës garantuese)
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 3 vite sipas garancionit të punimeve të Aneksi 6.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

		<p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	--	--

Për:	ZYREN E PROKURIMIT KOMUNA SUHAREKË
Nga:	AAB CONSTRUCTION SH.P.K., LUAN HARADINAJ SOL 1 HY.1 NR.4, PRISHTINË, NUI, 810842668
Lënda:	DEKLERATË PER KUALITETIN E PUNIMEVE
Datë:	25.07.2024

I/e nderuar,

Ndërtimi i QKMF-së në Gjinoc - RITENDER me numër identifikues: 624-24-5754-5-2-1 & 624-24-32-521

Për të përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 pika 1 dhe 34.5 (KVK) e kontratës së lartcekur.


Ne konfirmojmë se:

Ne si Operator Ekonomik pas pranimit përfundimtar të kryerjes së punëve ofrojmë garancion të rregullt 3 vjeçar, sipas formularit të tenderit të plotsuar nga OE: Duke siguruar garancion prej 10 % nga vlera e kontratës, si dhe deklarojmë mbi cilësinë e punës dhe mallrave në kohëzgjatje 3 vjet nga dita e pranimit përfundimtar të kryerjes së punimeve dhe obligohemi dhe pranojmë se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojmë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën ne pajtohemi se AK ato dëme do t'i sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të na faturojë ne si Kontraktor që kemi dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve.

Me respekt:

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit: ARLIND BUZHALA Nënshkrimi

Datë: 25.07.2024



OK

Për	KOMUNA SUHAREKË
Emri i Kontratës	Ndërtimi dhe funksionalizimi I QMF-Gjinoc

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PROJEKTIT: „Ndërtimi dhe funksionalizimi i QMF”

TIMORE DHE ZEJTARE

I	PUNIMET E DHEUT	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
1.1	Pastrimi i komplet terrenit ne hapsiren ku do te ndertohet objekti	m ²	1270.00	2.00 €	2,540.00
1.2	Pastrimi i terrenit dhe gerimimi i humusit deri ne 20 cm, pergaditja e terrenit per hapjen e themeleve shiritore	m ²	57.00	50.00 €	2,850.00
1.3	Pozicionimi gjeodezik, pikëtimi i tërë gabarilit të objektit sipas prijektit të arkitektures si dhe dhe shënjëzimi i objektit për ndërtim për tere siperfaqen e objektit me siperfaqe te perdheses s=265m2, piketimi i objektit te behet neper te gjitha skajet e objektit.	cope	1.00	3,000.00 €	3,000.00
1.4	Gerimimi dheut i kat.III me makine per hapjen e themeleve shiritore dhe transporti i dheut ne deponin e caktuar Gerimimi te behet sipas kuotave te dhena ne projekt Siperfaqet anesore te gemimit te jene te rregullta, ndersa fundi te jete i niveluar sipas kuotave te dhena. Llogaria ne m ³	m ³	250.00	2.00 €	500.00
1.5	Shtirirja, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit fraksion 0-63 mm nën themele dhe ne perimete te mureve te themelit nga dy anet e tyre t=20 cm Llogaria në m ³	m ³	120.00	20.00 €	2,400.00
1.6	Shtirirja, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit fraksion 0-30 mm nën themele dhe pllake te perdheses t=10 cm. Llogaria në m ³	m ³	40.00	10.00 €	400.00
	TOTAL PUNIMET E DHEUT			€	11,690.00

Poz.	PUNIMET E BETONIT DHE ARMATURES	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
I	Furnizimi me material si dhe betonimi i shtruses rrafshuese nga betoni i paarmuar C-25/30 per shputen e themelit shirit dhe bazen e pllakes mbicokull. betonimi me trashesi 5cm.	m ³	20.00	20.00 €	400.00
II	Furnizimi me beton, kallupimi dhe betonimi i themeleve te mureve mbrojtese, mureve dhe shkallezimeve sipas profilit tërthor të dhënë C-30/37 sipas llogaris statike, betoni te jete i papërshkrushem nga uji (te perdoren aditiv përkatës kundër ujit dhe ngricave, kriprave), llogaria per m3 te betonit ne veper.	m ³	60.00	100.00 €	6,000.00
	Betonimi i themeleve shiritore dhe trajeve te themelit (xokiles) sipas pershkrimit dhe specifikitmit teknik, nga betoni i armuar MB 30. Llogaria në m ³	m ³	50.00	100.00 €	5,000.00
2.1	Betonimi i pllakes së Perdheses ,Katit dhe kulmit nga bet.arme, MB 30, Pllaka t=20 cm, ne llogaritje perfshihen edhe traret lidhes te pllakes. Llogaria në m ³	m ³	160.60	100.00 €	16,060.00
2.2	Betonimi i shtyllave te veçuara dhe shtyllave pjeserisht të integruara ne mure dhe muret e atikes. Nga betoni armuar MB 30. Llogaria në m ³	m ³	28.00	100.00 €	2,800.00
2.3	Betonimi i trajeve te objektit, trajeve te mbidyerve dhe dritareve, nga bet arm. MB 30 Llogaria në m ³	m ³	8.00	100.00 €	800.00
2.4	Betonimi i shkallëve te brendëshme dhe te mbrendeshme nga bet. arm. MB 30 me pahi dhe skele të nevojshme. Llogaria në m ³	m ³	4.70	100.00 €	470.00
2.5	Furnizimi me material dhe betonimi i atikës me beton arme të markës MB 30. Llogaria në m ³	m ³	5.80	100.00 €	580.00
2.6	TOTAL PUNIMET E BETONIT DHE BETONIT			€	32,110.00

	Pershkrimi i Puneve	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
Poz.	PUNIMET E ARMATURES				
III	Furnizimi, transportimi, prerja, lakimi, punimi dhe vendosja e armatures se brinjezuar S400/500 per murin mbrojtës dhe objektin e QMF-se, me seksione te prerjes tertshore Ø8mm Ø10mm Ø12mm Ø14mm Ø16mm Logaritete ne kg	kg	3629	1 20 €	43 548 00
3.1	TOTAL PUNIMET ARMATURES				€ 43,548.00

Poz.	PUNIMET E MURATIMIT	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
IV	Muratimi i mureve me blloqe gysëm giter, t=25cm, me llaç vazhdues 1.2*6. Ne llogari hyn edhe skela e nevojshme per muratim. Llogaria në m2	m ²	600.00	8.00 €	4,800.00
4.1	Muratimi i mureve me blloqe gysëm giter, t=20cm, me llaç vazhdues 1.2*6. Ne llogari hyn edhe skela e nevojshme per muratim. Llogaria në m2	m ²	150.00	35.00 €	5,250.00
4.2	Muratimi i mureve me blloqe giter, t=12cm, me llaç vazhdues 1.2*6. Ne llogari hyn edhe skela e nevojshme per muratim. Llogaria në m2	m ²	141.00	5.00 €	705.00
4.5	TOTALI I PUNEVE TE MURATIMIT				€ 10,755.00

Poz.	PUNIMET E SUVATIMIT MURE + TAVANE	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
V	Suvatimi i tavanit me llaç vazhdues ne dy shtresa dhe me sperkatje paraprake më lëng çimentoje, Ne cmim hyn edhe skela e nevojshme! Llogaria në m ²	m ²	484.60	7.00 €	3,392.20
5.1	Suvatimi i mureve te brendeshme me llaç vazhdues ne dy shtresa dhe me sperkatje paraprake më lëng çimentoje. Ne cmim hyn edhe skela e nevojshme! Llogaria në m ²	m ²	1468.00	7.00 €	10,276.00
5.2	TOTALI I SUVATIMEVE MURE + TAVANE				€ 13,668.20

Poz.	PUNIMET E NIVELIZIMIT	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
VI	Nivelizimi i të gjitha dyshemeve, në të gjitha katet, me estrih. Treshësia duhet te jetë 7 cm. dhe kjo behet per arsye te nivelimit te dyshemeve me materiale te ndyshme. (Shiqo detajet). Në qmim duhet të llogaritet edhe stropori N4 dhe trashësi 5 cm, shiriti perimetrik (dichtung) i izolimit të estrihut nga muret Llogaria në m ²	m ²	484.60	15.00 €	7,269.00
	TOTALI I PUNEVE TE NIVELIZIMIT				€ 7,269.00

Poz.	PUNIMET E IZOLIMIT	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
VII	Furnizimi transporti me material hidroizolues "Bauder" ose ekuivalent , dhe hidroizolimi i dyshemes se perdheses dhe mureve të themeleve të nëndheshme të Objektivit me një lyerje të ftohtë (bitulit) dhe me dy shtresa një Kondor4 mm dhe një "Bauder" 5 mm "index" ose ekuivalent trashësi t = 4 mm . Ngjitja bëhet me flakë, kurse kalimi i shtresave është 10 cm. Në qmim të përfshihet edhe një shtresë "Styrodur" N4 trashësi 5 cm për mbrojtjen e hidroizolimit si dhe një shtresë folie mbrojtëse "Fondolin" ose "Tefond" ose ekuivalent.	m ²	380.00	0.50 €	190.00
7.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shtreses hidroizoluese në dysheme dhe mure deri në lartësi 60cm të hapsirave higjienike , izolimi i dyshemeve me ARDULAN 8x9 (2 HERË) ose ekuivalent.	m ²	60.00	1.00 €	60.00
7.2	TOTAL PUNIMET E IZOLIMIT				€ 250.00

	Pershkrimi i Puneve	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
Poz.	PUNIMET E KULIMIT				

Handwritten checkmarks and initials on the right margin of the document.

VIII	Furnizimi, transportimi dhe punimi i konstruksionit te kulmit nga druri i plote teknik i shendosh sipas detajeve ne projekt si konstruksion klasik kullem i pjerrret me ramje prej 30° i punuar me karrik trefishe me qeprata te ankeruara ne konstruksionin e pllakes senderkatit. Ne komplet konstruksionin e kulmit parashihen keto shtresa: -brinjjet(mahite) 12x10cm -trajet e unazes mbajttese 14x16cm -trajet e kurores 10x12cm -mveshja me drrasa t=1.6cm -folia difuzive -listellat+kunderlistela 3x5cm -mbulesa llamarine e plastifikuare valuar t=0.5mm. -kulumar adekuat nga llamarinae plastifikuar t=0.5mm Logaritet komplet ne sipër. tepjerrret te kulmit ne-m²	m²	290.00	35.00	€	10,150.00
B.1	TOTAL PUNIMET E KULMIT TE RRAFHSHT				€	10,150.00
PUNIMET E ZDRUKTHARISE						
		Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi		Total Qmimi €
IX	Furnizimi, transporti dhe montimi i Dyerve nga druri i thatë sipas skicave të dhëna me të gjitha pjesët e nevojshme për montim (mbajtëset, dorëzat, qelësat ...etj) me dimensione si me poshte:					
9.1	dim:100/210	cope	14.00	250.00	€	3,500.00
	Furnizimi dhe montimi i dyerve te sanitarive te punuar prej PVC, komplet me pergaditjet paraprake per vendosjen e dyerve. Dimenzionet sipas projektit.					
9.2	dim:80/210	cope	11.00	120.00	€	1,320.00
	dyer të toaleteve për hendikep 120x200/120x100 cm	cope	1.00	120.00	€	120.00
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të jashtme e punuar prej PVC, komplet me pergaditjet paraprake per vendosjen e dyerve. Dimenzionet sipas projektit.					
9.3	dere - vitrine dim:340/280	cope	2.00	380.00	€	760.00
	dim:100/260 - tek kalldatorja	cope	1.00	500.00	€	500.00
	Furnizimi, transporti dhe montimi i Dritareve nga PVC me ngjyre te bardhe sipas skicave të dhëna me të gjitha pjesët e nevojshme për montim (mbajtëset, dorëzat, qelësat ...etj) me dimensione si me poshte:					
9.4	240/180	cope	12	300.00	€	3,600.00
	100/355	cope	2	120.00	€	240.00
	50/80	cope	6	50.00	€	300.00
	395/180	cope	2	400.00	€	800.00
	480/180	cope	1	928.00	€	928.00
	100/100	cope	2	108.00	€	216.00
	230/260	cope	2	650.00	€	1,300.00
	TOTAL PUNIMET E ZDRUKTHARISE				€	13,584.00
PUNIMET ME METAL						
		Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi		Total Qmimi €
X	Punimi dhe montimi i gardhit te shkallive te punuara nga tubat /gypat/ e metalit me dimenzione Ø 40 mm dhe Ø 60 mm. Gardhi te punohet sipas detajeve te dhena ne skeme dhe detalin e gardhit. Ulogaria në m³	m³	28.00	30.00	€	840.00
	Furnizimi me material dhe punimi i gardhit të rampave të pjerrëta rrethoja të punohet me profile Ø40x40x3 mm të ankeruara në pjesët e epërme të rampave me anë të pllakave të me dimensione 100x100x5 mm me anker bulona. Mbajtësit kryesor montohen në distancë 120 cm. Dorëza e gardhit për të rritur të punohet nga tubi Ø60x3 mm në lartësi 100 cm ndërsa dorëza e gardhit për fëmijë nga tubi Ø 60x3 mm në lartësi 60 cm. Mbushja e rrethojës të bëhet me shufrë Ø 10 mm në çdo 10 cm. Mbrojtja e rrethojës metalike duhet të bëhet me anë të lyerjes me dy shtresa ngjyrë bazë dhe dy shtresa ngjyrë të yndyrshme të cilat në mes veti duhet të ndryshojnë për nga një nuancë. Ngjyra finale duhet të jetë e hirtë Antracit	m ^l	4.50	50.00	€	225.00

10.1	<p>Furnizimi me material dhe punimi i rrethojës metalike me lartësi totale 160 cm përgjatë tërë kufijve të parcelës.</p> <p>Shtyllat kryesore të rrethojës metalike janë 60x60x3 mm në çdo 210 cm të ankeruara 30 cm në cokllën e betonit. Fusha mes shtyllave kryesore mbushet me profile 20x20x2 mm në çdo 15 cm të salduara mes dy profileve 30x20x2 mm në anën e poshtme dhe të epërme. Rrethoja ankerohet në cokllën nga betoni i armuar.</p> <p>Coklla e betonit duhet të jetë me gjerësi 20 cm dhe lartësi 80 cm prej të cilave 40 cm duhet të jenë nën tokë. Coklla e betonit të armuar të mbështetet mbi themele të veçanta me dimensione 40x40x40 cm nga betoni i ngjeshur të punuar në distancë të njëjtë aksiale si shtyllat kryesore të rrethojës.</p> <p>Në kuadër të rrethojës metalike duhet të punohen edhe dyert rrëshqitëse me gjerësi 6 m pjesën e hyrjes në parking dhe dyert rrëshqitëse me gjerësi 4 m për hyrjen e kembësoreve.</p> <p>Mbrojtja e rrethojës metalike duhet të bëhet me anë të lyerjes me dy shtresa ngjyrë bazë dhe dy shtresa ngjyrë të yndyrshme të cilat në mes veti duhet të ndryshojnë për nga një nuancë. Ngjyra finale duhet të jetë e hirtë Antracit.</p> <p>Në çmim duhet të përfshihen edhe punët e gërmimit, mbushjes dhe ngjeshjes së zhavorit, kallëpimi, armimi dhe betonimi i elementeve të cekura më lartë.</p>	m ¹	128.00	60.00	€	7,680.00
10.2	TOTAL PUNIMET ME METAL DHE ALUMIN				€	8,745.00
	Pershkrimi i Puneve	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi		Total Qmimi €
Poz.	PUNIMET E QERAMIKES					
XI	<p>Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë epokside nga poliuretani duke përfshirë trajtimin paraprak të bazës së estrihut me makinë gërryese dhe thithje të pluhurit për eliminimin e shtresës së dobët që të mundësohet ngjitje sa më e mirë.</p> <p>Dyshemeja epokside të realizohet me shtresat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shtresa e parë bazë epokside • Shtresa e dytë bazë epokside me shtesa të reres së kuarcit. • Shtresa e poliuretanit dy komponentësh me trashësi nga 2-3 mm me çipsa dekorativ shumëngjyrësh sipas dëshirës. • Shtresa e poliuretanit dy komponentësh si lyerje transparente për mbrojtjen e dyshemesë nga rrezet UV. • Shtresa e politurës si lyerje transparente për mirëmbajtje më të mirë. <p>Ngjyra: të përcaktohet në koordinim me organin mbikqyrës të caktuar nga investitori. Në çmim përfshihen të gjithë aksesoret e nevojshëm, kendet në perimetër të mureve e të tjera gjër në funksionalizim të elementit.</p>	m ²	449.50	25.00	€	11,237.50
11.1	<p>Furnizimi me material dhe vendosja e pllakave të qeramikes për dysheme dhe mure në një sanitare t=0.8 cm dhe dimensione sipas perzgjedhjes së AK, të klasit të parë me ngjitës të pllakave ose ekuivalent, në çmim parashihen ngjitësi i pllakave dhe fuga. Ngjyra të përcaktohet nga arkitekti.</p> <p>Llogaria në m²</p>	m ²	205.00	18.00	€	3,690.00
11.2	TOTAL PUNIMET E QERAMIKES				€	14,927.50
	Pershkrimi i Puneve	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi		Total Qmimi €
Poz.	PUNIMET E MERMERIT					
XII	<p>Furnizimi dhe montimi i pllakave të mermerit në Shkallet e mbrendshme, shkeleset e shkalleve nga mermeri t=2,0cm, gjersia 30cm ndersa gjatesia 140 cm.</p> <p>Llogaria në cope</p>	cope	19.00	30.00	€	570.00
12.1	<p>Furnizimi dhe montimi i pllakave të mermerit në Shkalle, balloret t=1,0cm lartesia 16 cm</p> <p>Llogaria në cope</p>	cope	20.00	30.00	€	600.00
12.2	<p>Furnizimi dhe montimi i pllakave të mermerit në pushimoret e Shkalleve nga mermeri t=2,0 cm</p> <p>Llogaria në m²</p>	m ²	5.00	30.00	€	150.00
12.3	<p>Furnizimi me material dhe montimi i solbankave të fasades në anën e jashtme (në fasadë) nga mermeri me trashësi 2,0 cm dhe me gjersi 18,0 cm me punimin e "kanalit" të pikores</p> <p>Llogaria në m'</p>	m'	47.00	15.00	€	705.00

✓
✓

✓

✓
✓

✓
✓
✓
✓

12.4	Furnizimi me material dhe montimi i sobbankave të në anën e brendshme të ambienteve nga mermeri me trashësi 2,0 cm dhe me gjerësi sipas nevojës. Sobbanka duhet të ketë "kanalin" e pikores sipas specifikacionit në projekt. Llogaria në m'	m'	47.00	15.00	€	705.00
	Shkallët e jashtme së bashku me rampën duhet të mvishen me pllaka graniti me teksturë të vrazhdë të parrëshqitshme, të përpunuar me fiakë, të ngjitura me një shtresë llaçi të çimentosë së paku 2 cm të trashë drejtpërdrejtë mbi shtresën e nivelizuar e cila paraprakisht është hidroizoluar me izolim të lëngët dykomponentësh. Shkëlëset e shkallëve dhe rampat punohen nga pllakat me trashësi 3 cm ndërsa të gjitha pjesët tjera, si balloret dhe pushimoret mvishen me pllaka graniti me trashësi 2 cm. Gjerësia e pllakave për shkëlëset e shkallëve dhe rampave duhet të jetë si në detajet e projektit.	m ²	20.00	55.00	€	1,100.00
12.5	TOTAL PUNIME ME MERMER				€	3,830.00

Poz	Pershkrimi i Puneve	Njësia	Sasia	Qmimi / Njësi	Total Qmimi €
	PUNIMET ME LLAMARINE				
XIII	Furnizimi dhe montimi i lamarines për mvishjen e atikes t=1.5m. Me lamarine te plastifikuar me trashesi t=0.6 mm.	m'	72.00	10.00	€ 720.00
